



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS**

PROCESVERBAL

I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2026-2028 TË BASHKISË KAMËZ

I mbajtur më 23.07.2026 në orën 11:00, në dëgjese me banorët e Bashkisë Kamëz, për Rishikimin e Planit të Integritetit 2026-2028.

Takimi u zhvillua në Sallën e Rinisë, Pallati i Kulturës “Artan Cuku”.

Të pranishëm në takim:

- Zëvendëskryetar i Bashkisë Kamëz, Kryetar i Grupi të Punës dhe Koordinator i Integriteti, z.Gentian Bicukaj;
- Drejtoresha e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kamëz, znj. Besurie Doda;
- Drejtoresha e Integritetit në BE, Projekteve të Huaja dhe Zhvillimit Ekonomik, znj. Peme Marku;
- Anëtarë të Këshillit Bashkiak;
- Grupi i Punës;
- Banorë të Bashkisë Kamëz.

Takimin e hapi Zv. Kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Gentian Bicukaj, i cili pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, theksoi rëndësinë e Planit të Integritetit si një dokument strategjik të bashkisë për krijimin e një administrate që i kundërvihet korrupsionit, është transparente, inovative dhe e përgjegjshme për qytetarët.

Në vijim, ai bëri me dije se hartimi i Planit të Integritetit 2026–2028 është bazuar në:

1.Kuadrin bazë të politikave kundër korrupsionit si:

- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Plani i Veprimit 2024-2026;
- Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 dhe plani i saj

i veprimit 2023-2025;

- Rekomandimet e GRECO-s (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) për forcimin e integritetit në nivel vendor;
- Aktet ligjore dhe nënligjore bazë për qeverisjen Vendore;
- Aktet e reja ligjore dhe nënligjore në fushën e etikës, transparencës, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes vendore;
- Aktet e reja ligjore e nënligjore 2024-2026, në fushën e antikorrupsionit, transparencës, konfliktit të interesit, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes vendore.

2. Në nivel vendor, plani u mbështetet gjithashtu në:

- Rregulloren e Këshillit Bashkiak Kamëz, e cila garanton transparencën në vendimmarrje, konsultimin publik dhe përcakton procedurat e raportimit ndaj qytetarëve dhe organeve të mbikëqyrjes;
- Politikat ekzistuese të Bashkisë për qeverisje të hapur, buxhetim me pjesëmarrje, etike publike dhe menaxhim të riskut.

Më pas, z. Bicukaj u ndal tek objektivat e identifikuar dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit :

Objektivi 1. Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit.

Objektivi 2. Zhvillimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit.

Objektivi 3. Transparenca dhe llogaridhënia publike proaktive, si dhe menaxhimi i integritetit në fusha të veçanta të bashkisë.

Në mbyllje të takimit, z. Bicukaj, falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Bashkisë dhe qytetarëve në funksion të rritjes së transparencës dhe forcimit të besimit të qytetarëve.

Takimi u mbyll në orën 12:00.

